

VKM Nr:414 , datë 8.6.2011, “Vendim për krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësimit”

Dekretit nr. 448/1988 i Presidentit të Republikës italiane

Dr. Erjona Canaj” Ndërmjetësimi tregtar si një mundësi bashkëkohore e zgjidhjes së konfliktit”
Prof. Dr. Ismet ELEZI, në manualin “Ndërmjetësimi për pajtim në konfliktet penale”, Tiranë, 2004

Alketa Elezi “Ndërmjetësimi në mosmarrëveshjet penale në kontekstin e drejtësisë rehabilituese” Jeta juridike Nr.1, Mars 2010.

D. DOLLING TäterOpfer-Ausgleich in Deutschland, Forum Verlag Godesberg, Bonn 1998.
45 II JGG ,Jugendgerichtsgesetz

F. Dünkel: “La mediazione in Germania”, në La mediazione nel sistema penale minorile,

Bernhard Trummer dhe G. Kaufmann, në “La mediazione nel sistema penale minorile, L. Picotti”
Ref. A. Ceretti: “Una risposta al minore autore di reato: la mediazione penale”, në Justitia, 1997

vol. 4

G.V. Pisapia në “Rassegna italiana di criminologia”, nr° 4, 1993.

Kontrata e porosisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë

Sbkëndi Çili

Abstrakt

Kontrata e porosisë parashikohet në nenin 913 të Kodit Civil. Sipas këtij neni: “Porosia është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet të kryejë një ose më shumë veprime juridike për llogari të palës tjetër». Pra, i porosituri vepron për llogari të porositësit por në emrin e tij. Theksojmë se, ai nuk është i detyruar të tregoj se për llogari të cilit person po kryen veprimin juridik dhe se të tretët nuk kanë asnjë lidhje me porositësin. Ata nuk mund të kundërshtojnë kryerjen e veprimit vetëm për këtë fakt, edhe pse mund të kenë djeni për porosinë. Por ai mund të veproj jo vetëm në llogari por dhe në emër të porositësit. Pra, në këtë moment, i referohemi nenit 914 i Kodit Civil i cili parashikon se: Në qoftë se të porositurit i është dhënë kompetenca për të vepruar në emër të porositësit, zbatohen dispozitat mbi përfaqësimin, nënkupton se, pavarësisht mënyrës se si vepron i porosituri, veprimi për llogari nënkupton që pasojat e veprimit juridik të kryer janë të destinuara për porositësin. Veprimi për llogari nënkupton dhe interesin e porositësit. Në këtë punim, kam theksuar se, porosia përfshin jo vetëm veprimet juridike të treguara në kontratë, por dhe veprimet e domosdoshme për kryerjen e tyre, duke iu referuar nenit 917/ 1 i Kodit Civil. Veprimet që nuk janë të domosdoshme apo nuk kanë lidhje me ekzekutimin e saj mund të ndikojnë negativisht duke zgjeruar objektin e kontratës. Këto veprime të domosdoshme mund të mos jenë parashikuar shprehimisht në kontratë. Kontrata e porosisë është e vlefshme dhe për këto veprime që nuk janë të shprehura në përmbajtjen e saj, por që janë të domosdoshme për përmbushjen e porosisë. I porosituri ka barrën e provës, të provoj domosdoshmërinë e veprimeve ndihmëse (në mënyrë që të ketë të drejtën e shpërblimit dhe rimbursimit të shpezimeve).

***Fjalët kyçe:** kontratë, porosi e përgjithshme; e posacme, porositësi, i porosituri.*

Vështrim historik i kontratës së porosisë

Kontrata e porosisë nga pikëpamja historike është mjaft e hershme. Ajo ka qënë parashikuar si një kontratë mjaft e rëndësishme që *në të drejtën romake*. (Mandro, 2007, fq.386). E drejta romake jepte këtë përkufizim për kontratën e porosisë: *“marrëveshje midis dy palëve (subjekteve) nga të cilat njëra palë (porositësi) i jep palës tjetër (të porositurit) detyrën për të kryer për llogari të tij ose të një personi të tretë një veprimtari të caktuar”*. (Dhima, 2007, fq. 665).

Sipas autores Arta Mandro, ajo njihet si kontratë konsensuale, e dyanshme imperfekte, sepse detyrimet ekzistonin vetëm për të porositurin. Megjithatë i porosituri mund të merrte shpërblim për veprimtarinë që realizonte në formë mirënjohjeje, dhe jo si kundërdetyrim i porositësit. (Mandro, 2007, fq.386)

Objekti i kontratës ishte kryerja e çdo lloj veprimtarie nga i porosituri dhe jo vetëm kryerja e veprimeve juridike. Kontrata klasifikohet në “mandatum generale” dhe “Mandatum unis rei”. *Mandatum generale* konsistonte në detyrimin e të porositurit për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme në funksion të administrimit të pasurisë së porositësit. *Mandatum unis rei* parashikonte detyrimin e të porositurit të kryente një punë të përcaktuar. (Mandro, 2007, fq. 387)

Klasifikimi i kontratës së porosisë

Për qëllime teorike dhe praktike kontratën e porosisë mund t'a klasifikojmë në disa lloje. Veçanërisht neni 917 i Kodit Civil vendos dallimin ndërmjet *porosisë së përgjithshme* dhe *porosisë së veçantë*. Dallim, i cili i referohet *shtrirjes së objektit të kontratës*. Sipas natyrës së këtyre veprimeve realizohet klasifikimi në porosi të përgjithshme dhe porosi të veçantë. Neni 917 i Kodit Civil parashikon se : *“Porosia përfshin jo vetëm veprimet për të cilat është dhënë, por edhe ato akte që janë të domosdoshme për kryerjen e tyre. Porosia e përgjithshme nuk përfshin aktet që tejkalojnë administrimin e zakonshëm të punës, po qe se nuk cilësohen shprehimisht”*.

Porosia e përgjithshme shtrihet vetëm për veprimet e administrimit të zakonshëm. Ligji vet nuk shprehet se çfarë përfshin porosia e përgjithshme. Mjaftohet vetëm me përjashtimin nga përmbajtja e saj të akteve që tejkalojnë administrimin e zakonshëm të punës.

Porosia e posaçme (e veçantë) ka të bëjë me kryerjen e veprimeve juridike të veçanta që janë të përcaktuara qartë. Ajo jepet për kryerjen e veprimeve juridike që tejkalojnë kufijtë e administrimit të zakonshëm. Për këto veprime neni 917 i Kodit Civil parashikon se duhet të cilësohen shprehimisht (të tregohen në mënyrë qartë).

Nga interpretimi i dispozitave të tjera mund të bëhet një klasifikim tjetër. Klasifikim i cili bazohet në faktin që në secilën prej palëve mund të ndodhen disa persona. Sipas këtij klasifikimi kemi:

Sipas nenit 932 të Kodit Civil, *porosi kolektive* kemi nëse jepet nga shumë porositës në një akt të vetëm dhe për një çështje me interes të përbashkët. Interesi është i lidhur me kryerjen e një veprimi juridik të vetëm.

Ndërsa sipas nenin 934 të Kodit Civil, *porosi e përbashkët* i jepet disa personave të cilët duhet të veprojnë bashkarisht. Në këtë rast marrëdhënia juridike shuhet nëse shkak i shuarjes ka të bëjë me vetëm njërin prej tyre.

Porosi e veçantë i jepet disa të porositurve të cilët duhet të veprojnë në mënyrë të veçantë nga njëri tjetri. Marrëdhënia juridike nuk shuhet nëse shkak i shuarjes vërtetohet vetëm për njërin prej tyre.

Porosia mund të jetë e thjeshtë apo profesionale.

Porosi e thjeshtë është e tillë që mund të realizohet nga çdo subjekt pa qënë e nevojshme pasja e njohurive profesionale të përcaktuara.

Porosia mund të jetë *profesionale* kur i porosituri gëzon njohuri profesionale në një fushë të caktuar dhe disponon mjetet e nevojshme teknike profesionale për kryerjen e saj.

Dispozitat që parashikojnë kontratën e porosisë kanë *karakter të përgjithshëm*. Ato janë të zbatueshme dhe për kontrata të tjera (porosi të veçanta) për aspekte të cilat, ato nuk i rregullojnë në mënyrë të plotë. Këto dispozita do të zbatohen për kontratën e komisionit e spedicionit të cilat i referohen shprehimisht këtyre dispozitave, konkretisht neni 944 të Kodit Civil. Janë të zbatueshme për kaq sa i përshtatet natyrës së tyre, si lloje të veçanta porosie.

Veçoritë e kontratës së porosisë

Së pari, kontrata e porosisë është *kontratë konsensuale*. Sipas nenit 676 të Kodit Civil, ajo quhet e lidhur kur palët kanë shfaqur në mënyrë të ndërsjelltë vullnetin e tyre, duke u marr vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj. Kushtet thelbësore të kontratës janë ato të parashikuara në nenin 663 të Kodit Civil, i cili parashikon se : *“Konditat e nevojshme për qënien e kontratës janë : pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkak i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji”*. Porosia do të quhet e lidhur kur palës që bën propozimin për lidhjen e porosisë, i mbërrin pranimi i palës tjetër. (Semimi T.,1998, fq.68)

Ajo është *kontratë joformale*. Lligji nuk kërkon detyrimin e respektimit të një formetë caktuar. Në parim pranohet liria e formave. Forma *nuk* kërkohet *ad substantiam*. Kontrata mund të lidhet me shkrim (akt noterial ose shkresë e thjeshtë), me gojë dhe me veprime konkludente.

Sipas nenit 921/ 2 të Kodit Civil, ajo *kanatyre personale (intuitu personae)*, e lidhur me cilësitë personale të të porositurit. Porosia bazohet në besimin që ka personi që jep porosinë mbi personin e të porositurit. Këtej rrjedh se :

- a. I porosituri nuk mund të zëvendësohet nga të tjerët në ekzekutimin e porosisë përveç rasteve të parashikuara nga neni 921/2 i Kodit Civil.
- b. Porosia shuhet si pasojë e vdekjes së porositësit apo të porositurit përveç përjashtime të parashikuara në nenin 927 dhe 928/2 të Kodit Civil.
- c. Porositësi ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata kur nuk ekziston më ky besim te i porosituri. (Galvano, 1999, fq.672).

Kontrata e porosisë është *kontratë dypalëshe*. Pavarësisht nëse në të marrin pjesë shumë subjekte. Ato grupohen në jo më shumë se dy palë. Kontrata e porosisë është *kontratë e dyanshme*. Theksojmë se, sipas nenin 662 të Kodit Civil, kontrata është me detyrime të dyanshme, kur palët detyrohen reciprokisht ndaj njëra tjetres.

Veçori tjetër e saj është karakterime *shpërblim*. Shpërblimi *prezumohet*. I porosituri detyrohet të kryej veprimin/veprimet juridike kundrejt shpërblimit. Kjo veçori është e lidhur me karakterin e dyanshëm të kontratës. Referuar nenit 920 dhe 925 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, rezulton se, kryerja e veprimit juridik bëhet kundrejt shpërblimit.

Porosia mund të jetë *me afat të caktuarose me afat të pacaktuar*. Porosia mund të jepet *dheme kusht*. Kushti mund të ketë natyrë të ndryshme. Në vendimin nr. 1886 datë 04.04.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur ndër të tjera, se: *“...marrëveshja do të prodhonte pasoja juridike vetëm po të fitohet çështja në gjykim ku paditësi/i kundërpaditur (i porosituri) ishte përfaqësues i të paditurit/kundrapaditës (porositësit). Kushti lidhet me faktin e fitimit ose jo të çështjes në gjykim. Vetëm në këtë rast do të mund të realizoheshin veprimet e tjera si vënia në ekzekutim e vendimit, dorëzimi i banesës, shitja dhe dhënia e shpërblimit...”*. Pra kushti mund të jetë i lidhur me rezultatin e favorshëm të veprimit juridik apo si në rastin konkret me fitimin e gjykimit.

Marrëdhënia juridike e porosisë

Marrëdhëniet shoqërore që krijohen midis subjekteve të së drejtës dhe që rregullohen nga normat juridike konsiderohen marrëdhënie juridike. Marrëdhënia juridike lind ndër të tjera dhe nga kontratat. Kontrata e porosisë si çdo kontratë tjetër krijon marrëdhënie juridike midis palëve. Është pikërisht, neni 659 i K.Civil parashikon se : *“Kontrata është veprim juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë,*

ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”. Prej saj lindin dy lloj marrëdhëniesh juridike. (Kondili, 2007, fq.88)

- a. marrëdhënia juridike e brendshme midis porositësit dhe të porositurit.
- b. marrëdhënia juridike e jashtme, që lind nga kryerja e veprimit juridik, midis të porositurit dhe personave të tretë, palë të veprimit juridik.

Kontrata e porosisë rregullon vetëm marrëdhëniet që krijohen midis porositësit dhe të porositurit. Këto marrëdhënie nuk ndikojnë në marrëdhënien e krijuar nga veprimi juridik i kryer, midis të porositurit dhe personit të tretë (në parim).

Marrëdhënia juridike që krijohet nga kontrata e porosisë, si çdo marrëdhënie juridike tjetër ka këto element:

1. Subjektet midis të cilave krijohet marrëdhënia juridike.
2. Objekti i marrëdhënies juridike.
3. Përmbajtja e marrëdhënies juridike.

Marrëdhënia juridike e porosisë mund të jetë me element të huaj. “Elementi i huaj në kuptimin e të drejtës ndërkombëtare private është një rrethanë juridike, një moment i marrëdhënies juridike civile, i cili bëhet premisë për lidhjen e kësaj marrëdhënieje me një rend juridik të dhënë”. (Alia, 2006, fq.58). Elementi i huaj në marrëdhënien juridike mund të ndodhet në subjekt, objekt, ose në përmbajtje.

Cilët janë subjektet e marrëdhënies juridike të porosisë?

Në funksion të realizimit të qëllimit të kontratës së porosisë marrin pjesë tre palë. Palët janë porositësi, i porosituri dhe personi i tretë me të cilin i porosituri kryen veprimin juridik. Sipas nenit 915/ 2 i Kodit Civil, të tretët nuk kanë asnjë lidhje me porositësin. Ndërsa sipas nenin 932 dhe 934 të Kodit Civil, janë gjithmonë dy palë ku secila palë mund të ketë në brendësi disa subjekte.

Subjektet e marrëdhënies juridike janë personat që marrin pjesë në marrëdhënie si mbajtës të të drejtave subjektive dhe detyrimeve juridike përkatëse. Subjekte të marrëdhënies juridike të porosisë janë personat fizik dhe personat juridik. Ata për të qënë subjekte të marrëdhënies juridike duhet të karakterizohen nga pasja e zotësisë për të vepruar. (neni 6- 11 të Kodit Civil). Subjektit që i përket e drejta quhet kreditor ndërsa subjektit që i përket detyrimi quhet debitor. Subjektet mund të marrin emra specifik në varësi të marrëdhënies juridike konkrete. Në marrëdhënien juridike të porosisë subjektet quhen porositës dhe i porositur.

Porositësi është subjekti për llogari të të cilit i porosituri është i detyruar të përmbush veprimet juridike të treguara në kontratë. Kur porositës është një *person juridik*, të porositurit mund t'i ngarkohen vetëm ato veprime juridike që janë në zotësinë e tij juridike për të vepruar. (neni 29-31 Kodit Civil). Kur porositësi është *person fizik* ky duhet të ketë zotësi të plotë për të vepruar. Në qoftë se nuk ka zotësi të plotë për të vepruar vepron instituti i përfaqësimit dhe jo kontrata e porosisë. Kur nuk ka zotësi për të vepruar nuk mundet të lidh kontrata.

I porosituri është subjekti i cili detyrohet të përmbush një ose më shumë veprime juridike për llogari të një subjekti tjetër (porositësit). I porosituri është njëkohësisht subjekt i një marrëdhënieje juridike tjetër që krijohet me personin e tretë (marrëdhënie shitjeje, qiraje etj). Ai duhet të ketë zotësi të plotë për të vepruar, që të kryej veprimin juridik të ngarkuar nga porositësi

Objekti i marrëdhënies juridike

Objekti i marrëdhënies juridike janë *veprimet dhe shërbimet për lidhjen e veprimeve juridike*. Ajo përfshin dhe veprime ndihmëse që janë në funksion të kryerjes së veprimit juridik. (neni 917 K.Civil). Këto veprime ndihmëse mund të kategorizohen si veprime që përbëjnë objektin dytësor të kontratës. Nuk mund të jetë objekt kryesor i porosisë kryerja e veprimeve fizike materiale. Kjo sepse në një rast të tillë do ishim para kontratës së sipërmarrjes apo kontratës së punës.

Sipas nenit 913 të Kodit Civil : *“Porosia është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet të kryejë një ose më shumë veprime juridike për llogari të palës tjetër”*. Në nenin 916 parashikohet se : *“I porosituri është i detyruar të kryej punët ose veprimet juridike që i janë ngarkuarsipas udhëzimeve të porositësit”*.

Objekt i kontratës së porosisë duhet të plotësoj kërkesat e parashikuara nga ligji. Pra, neni 678 i K.Civil parashikon se: *“Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet”*. Ai duhet të jetë:

1. I ligjshëm. Porosia jepet për kryerjen e veprimeve juridike të ligjshme. Nuk mund të jepet porosi për të kryer veprime të paligjshme apo të kundërligjshme.
2. I mundshëm. Pamundësia e kryerjes së veprimit juridik i referohet kriterit fizik (pamundësia fizike për të kryer veprimin) apo juridik (kur veprimi juridik ka të bëjë me një objekt që është i përjashtuar nga qarkullimi civil). Gjithashtu nuk mund të jepet porosia për të kryer veprime që i ndalohen vet porositësit (Huet, 1996, 1112), si psh parashikimet e nenit 709 të Kodit Civil
3. I përcaktuar apo i përcaktueshëm. Përcaktueshmëria ka të bëjë me rastin kur të porositurit i jepet porosia për të kryer veprime të administrimit të zakonshëm. Këto veprime dhe pse nuk janë përcaktuar me saktësi janë të përcatueshme.

Objekt i kontratës mund të jetë një nga veprimet tregtare që parashikohen në ligjin nr. 7632, datë 4.11.1992. “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar“. Kontrata e porosisë në fushën tregtare do të trajtohet sipas dispozitave të Kodit Civil. Porosia do të përdoret si mjet për realizimin e veprimeve tregtare por do të rregullohet sipas dispozitave të Kodit Civil. Theksjomë se, neni 3 i ligjit nr. 7632, datë 4.11.1992. “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar“ parashikon se: “Konsiderohen veprime tregtare veçanërisht:

1. Blerja me qëllim rishitjeje, shitja që rrjedh nga një blerje e mëparshme e bërë me qëllim rishitjeje, si dhe përgjithësisht cdo veprim shkëmbimi i lidhur me një veprim tjetër shkëmbimi.
2. Çdo akt i sipërmarrjeve industriale, të ndërtimit, të shfrytëzimit të minerave, të transportit, të sigurimeve, të magazinimit, të shfaqjeve publike, të reklamës, të botimit e të shtypshkrimit joartizanal.
3. Çdo operacion bankar dhe këmbimi. Të gjitha operacionet ndërmjetëse tregtare, si dhe operacionet e ndërmjetësisë ose të spedicionit dhe ato të përfaqësuesve tregtarë.

Përmbajtja e marrëdhënies juridike në lidhje me kontratën e porosisë

Theksojmë se, përmbajtja e marrëdhënies juridike përbëhet nga tërësia e të drejtave dhe detyrimeve juridike përkatëse të subjekteve që marrin pjesë në marrëdhënien juridike konkrete. Trajtimi do të fokusohet në analizën e detyrimeve të palëve për aq sa detyrimet e njëres palë korrespondojnë me të drejtat e palës tjetër. Kontrata e porosisë si gjithë kontratat e tjera është burim i lindjes së detyrimeve. (neni 420 Kodi Civil). Të drejtat dhe detyrimet e porositësit dhe të të porositurit janë të lidhura ngushtësisht.

a) Detyrimet e të porositurit

Pjesën kryesore të përmbajtjes së porosisë e përbëjnë detyrimet e të porositurit. Çdo detyrimi të të porositurit i korrespondojnë drejta e porositësit. Klasifikimin i mëposhtëm bazohet në interpretimin e dispozitave përkatëse sipas vijueshmërisë së parashikimit tyre nga Kodi Civil. Përveç këtyre detyrimeve do të analizoj dhe një të drejtë të veçantë që i njihet të porositurit, e drejta e tij mbi kreditë në para.

b) Detyrimi i përmbushjes së porosisë

I porosituri është i detyruar të kryej veprimin juridik, objekt porosie. Në të kundërt mbi të do të bien pasojat që ligji parashikon për mospërmbushjen e detyrimeve

kontraktuale. Në vendimin nr. 1705 datë 23.10.2003, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, gjykata pasi saktësoi që kontrata e lidhur midis palëve nuk është sipërmarrje por kontratë porosie, shprehet se : *“...pranohet nga i padituri dhe provohet, që shumat përkatëse përbëjnë detyrime kontraktore të tij që ai duhet të detyrohet t'i shlyejë. Në një vështrim të përgjithshëm, mosshlyerja e detyrimeve i jep të drejtë (legjitimon) paditësin që të kërkojë zgjidhjen e kontratave, kthimin e shumave të dhëna dhe shpërblimin e dëmit...”*. (Neni 698 i Kodit Civil)

I porosituri mund të kryej veprimin juridik në emër të tij apo në emër të porositësit. Pra kemi dy mënyra të veprimit të të porositurit :

1. *Sipas nenit 913 të Kodit Civil, përcaktohet se, veprimi juridik mund të kryhet në llogari të porositësit por në emër të të porositurit.*Neni 915 i Kodit Civil parashikon se : *“I porosituri që vepron në emrin e vet fiton të drejta dhe merr përsipër detyrime që rrjedhin nga veprimet e kryera me të tretët, edhe po qe se këta kanë patur dijeni për porosinë. Të tretët nuk kanë asnjë lidhje me porositësin”*. Pasojat e veprimtarisë së të porositurit vijnë për të. Por ai është i detyruar që efektet e përmbushjes t'ia transferoj porositësit.
2. *Ndërsa sipas nenit 914 të Kodit Civil, përcaktohet se, veprimi juridik mund të kryhet në emër dhe për llogari të porositësit.* Në qoftë se të porositurit i është njohur e drejta për të vepruar në emër të porositësit, zbatohen dispozitat e përfaqësimit. Kontrata e porosisë në një rast të tillë shoqërohet me lëshimin e një prokure.

c) Detyrimi për të vepruar sipas udhëzimeve të porositësit

Neni 916 i Kodit Civil, *përcakton se, i porosituri është i detyruar të kryejë punët ose veprimet juridike që i janë ngarkuar sipas udhëzimeve të porositësit. Ai mund të largohet nga këto udhëzime vetëm kur kjo është e domosdoshme për të mbrojtur interesat e porositësit dhe nuk ka mundësi që të merret vesh më parë me të.*

Në parim i porosituri gjatë kryerjes së vepimit juridik që i është ngarkuar nuk duhet të largohet nga udhëzimet e marra. Nëse largohet nga udhëzimet duhet të merret vesh me porositësin. Detyrimi i veprimit sipas udhëzimeve të porositësit nuk përjashton mundësinë e largimit kur është e domosdoshme. Ligji parashikon dy kushte, që duhet të ekzistojnë bashkarisht, për të lejuar të porositurin të largohet nga udhëzimet e marra. Këto kushte janë:

1. *Domosdoshmëria e largimit nga udhëzimet në interes të porositësit.*Kërkohej domosdoshmëria e largimit, nuk mjafton qëllimi në interes të porositësit. Kur është e domosdoshme dhe në interes të porositësit largimi nuk prezantohet vetëm si *mundësi por dhe si detyrim* i të porositurit.

2. *Mospasjen e mundësisë për t'u marrë vesh paraprakisht me porositësin.*Kjo pamundësi për t'u marrë vesh me porositësin nënkupton pamundësinë e komunikimit me të në mënyrë që ai të jap udhëzimet e nevojshme apo të ndryshoj udhëzimet e mëparshme.. Në këtë përfundim mund të arrijmë nëse do të aplikojmë me analogji nenin 940 të Kodit Civil, i cili parashikon se, parashikon se : *“Komisioneri ka të drejtë të largohet nga udhëzimet që i ka dhënë porositësi vetëm kur, për shkak të ndryshimit të rrethanave, një largim i tillë bëhet i nevojshëm për interesat e porositësit, dhe komisioneri nuk mund të merret vesh më parë me porositësin ose, kur, megjithëse e ka pyetur , nuk ka marrë përgjigje në kohën e duhur”*.

Gjthashtu kur e ka pyetur por nuk ka marrë përgjigje fare mendoj se do të konsiderohet si pranim i heshtur i largimit.

ç) Detyrimi i njoftimit për ekzekutimin e porosisë

Ky detyrim është parashikuar nga neni 924 i Kodit Civil, sipas të cilit : *“I porosituri është i detyruar t'i jap porositësit, kur ky i kërkon, të gjitha informatat që kanë lidhje me kryerjen e porosisë, së bashku me dokumentet justifikuese, t'i japë atij llogari posa të ketë kryer porosinë, si dhe t'i kthejë atij çdo gjë që ka marrë për shkak të kryerjes së porosisë..”*

Detyrimi kryesor që ka i porosituri është kryerja e veprimit juridik për të cilin është dhënë porosia. Prej këtij detyrimi rrjedhin një sërë detyrimesh të tjera. Ndër këto detyrime është dhe detyrimi i njoftimit. Detyrimi për të njoftuar porositësin për fillimin dhe ekzekutimin e porosisë. Njoftimi për ekzekutimin e porosisë përfshin tregimin e veprimit juridik të kryer. Veç të tjerave është i detyruar të paraqes dhe dokumentet justifikues.Njoftimi jepet pas kërkesës së porositësit. Konkretisht, neni 924 i K.Civil parashikon se: *“I porosituri është i detyruar t'i jap porositësit, kur ky i kërkon, të gjitha informatat që kanë lidhje me kryerjen e porosisë, së bashku me dokumentet justifikuese..”*

d) Detyrimi i dhënies llogari

I porosituri është i detyruar t'i jap porositësit, kur ky i kërkon, të gjitha informatat që kanë lidhje me kryerjen e porosisë, së bashku me dokumentet justifikuese, t'i japë atij llogari posa të ketë kryer porosinë, si dhe t'i kthejë atij çdo gjë që ka marrë për shkak të kryerjes së porosisë.(Neni 924 i Kodit Civil)

Parashikimi i këtij detyrimi buron nga fakti që i porosituri veprimin me personin e tretë e kryen për llogari të porositësit. Ky detyrim ka rëndësi të veçantë. I jep mundësi porositësit të kontrolloj nëse veprimtaria e kryer nga i porosituri

realizohet sipas kritereve të administrimit të mirë dhe përkujdesjes, (Simone, 2007, fq 1001), të parashikuar nga neni 921 i Kodit Civil. Nëpërmjet një veprimi të tillë porositësi njihet me veprimtarinë e kryer nga i porosituri.

Detyrimi i dhënies llogari ka *funksion kontrolli* nga porositësi për veprimtarinë e realizuar nga i porosituri.

dh) Detyrimi i kthimit

I porosituri është i detyruar t'i jap porositësit, kur ky i kërkon, të gjitha informatat që kanë lidhje me kryerjen e porosisë, së bashku me dokumentet justifikuese, t'i japë atij llogari posa të ketë kryer porosinë, si dhe t'i kthejë atij çdo gjë që ka marrë për shkak të kryerjes së porosisë. (Neni 924 i Kodit Civil).

Ai është i detyruar t'i dorëzoj porositësit, çdo gjë që ka marrë për shkak të kryerjes së porosisë. Në një rast të tillë rëndësi ka përcaktimi i gjithçkaje që është marrë për shkak të porosisë dhe asaj që është marrë me titull tjetër. Pra, përjashtohen ato pasuri që janë fituar nga i porosituri të lidhura me personin e tij.

Detyrimi i kthimit ka si objekt :

1. Kthimin e çdo gjëje që ka marrë nga personat e tretë.
2. Kthimin e çdo gjëje që është marrë nga porositësi, për të bërë të mundur ekzekutimin e porosisë dhe që nuk janë përdorur.

Sendet që porositësi i ka dhënë (furnizuar) të porositurit dhe sendet që i porosituri ka fituar në ekzekutim të porosisë duhet t'i kthehen porositësit. Kjo dispozitë duhet interpretuar e lidhur ngushtë e nenin 918 të Kodit Civil. Kur i porosituri refuzon t'i kthej sendet që ka fituar në ekzekutim të porosisë, porositësi mund të ngrej padinë e rivendikimit për të kërkuar kthimin. Kjo padi mund të ngrihet pasi sendet e fituara në këtë rast janë në pronësi të porositësit.

Objekt kthimi mund të jenë sende apo shuma në të holla. Kur detyrimi i kthimit ka të bëjë me shuma në të holla i porosituri duhet t'i kthej ato. Kur nuk dorëzon këto shuma aplikohen dispozitat për detyrimet monetare. (Nenet 445-454 të K.Civil). Mosdorëzimi i këtyre shumave nënkupton mospëmbushjen e detyrimeve kontraktuale prej të cilës lindin pasoja të ndryshme. Për këtë Gjykata e Lartë ka arsyetuar se : *"...pranohet nga i padituri dhe provohet, që shumat përkatëse përbëjnë detyrime kontraktore të tij që ai duhet të detyrohet t'i shlyejë. Në një vështrim të përgjithshëm, mosshlyerja e detyrimeve i jep të drejtë (legjitimon) paditësin që të kërkojë zgjidhjen e kontratës, kthimin e shumave të dhëna dhe shpërblimin e dëmit"*. (Vendimi nr. 1705 datë 23.10.2003, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, referuar nenit 698 të Kodit Civil).

e) Detyrimi për të kryer porosinë personalisht

Neni 921/2 i K.Civil përcakton se, *i porosituri detyrohet që të zbatojë porosinë personalisht, përveç rastit kur është i autorizuar t'ia kaloj një të treti, kur është i detyruar nga rrethanat, ose në mbrojtje të interesave të porositësit.*

Karakteristikë esenciale e kontratës së porosisë është elementi personal. Pra, pavarësisht elementit personal, i porosituri mund të ngarkoj një zëvendës për kryerjen e veprimit juridik, kur :

1. Autorizohet për një zëvendësim të tillë (mundësia e parashikimit me kontratë të zëvendësimit).
2. Detyrohet nga rrethanat (sipas natyrës së veprimit juridik).
3. Për mbrojtjen e interesave të porositësit.

Mendoj se kushtet e parashikuara në nenin 921/2 të Kodit Civil nuk duhet të interpretohen në mënyrë të ngushtë. Mundet që zëvendësimi të konsiderohet i ligjshëm kur edhe pse nuk ka qënë i autorizuar, nuk rezulton të jetë i ndaluar

f) Detyrimi për të kryer porosinë me përkujdesje

Neni 921/1 i Kodit Civil parashikon se: *"I porosituri detyrohet të zbatojë porosinë me besnikëri dhe përkujdesje. Ai duhet t'i bëjë të ditur porositësit rrethanat e krijuara që mund të sjellin revokimin e saj"*. (Neni 921/ 1 i Kodit Civil). Kjo dispozitë është shprehje e parimit të përgjithshëm për përmbushjen e detyrimeve të parashikuar nga neni 422 dhe 455 të Kodit Civil. Shprehimisht, neni 422 parashikon se : *"Kreditori dhe debitori duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me korrektesë, me paanësi dhe sipas kërkesave të arsyes"*. Ndërsa neni 455 i K.Civil *"debitori dhe kreditori duhet të tregojnë kujdesin e duhur e të jenë të përpiktë në përmbushjen e detyrimit sipas përmbajtjes së tij."*

Mendoj se rëndësi ka përcaktimi i masës së kujdesit që duhet të tregoj i porosituri në ekzekutimin e porosisë. Neni 921/1 i Kodit Civil jep vetëm një përcaktim të përgjithshëm për detyrimin e të porositurit për të vepruar me përkujdesje. Një përcaktim interesant bënte Kodi Civil i vitit 1929. Sipas këtij kodi, *i porosituri asht i detyruar me ekzekutiv porosinë me shkathtësinë e një ati familjeje të mirë.*

j) Detyrimi i ruajtjes së sendeve dhe të drejtave të porositësit

Po ashtu, neni 922 i Kodit Civil, parashikon se, *i porosituri duhet të marrë masa për ruajtjen e sendeve që janë dërguar për llogari të porositësit dhe të mbrojtje të drejtat e këtij*

të fundit kundrejt transportuesit, po qe se sendet paraqesin shenja dëmtimi ose kur kanë mbërritur me vonesë. (Neni 922 i Kodit Civil).

Ruajtja e sendeve shihet në dy aspekte :

1. *Ruajtja e sendeve të marra nga porositësi për zbatimin e porosisë.* psh sendet që ai i furnizon të porositurit sipas nenit 923 të Kodit Civil.
2. *Ruajtja e sendeve të dërguara te i porosituri për llogari të porositësi nga një person i tretë.* Nga interpretimi i dispozitës (shprehjes mbroj të drejtat kundrejt transportuesit) nënkupton se këto sende kanë si paraprijëse një kontratë transporti. Mbrojtja e të drejtave të porositësit kundrejt transportuesit bëhet nga i porosituri.

Konkluzione

1. Porosia jepet për kryerjen e veprimeve juridike dhe për veprime, punë të tjera. Në këtë kategori do të përfshihen dhe veprimet e tjera të ligjshme. Ajo përfshin dhe veprime që mund të mos jenë parashikuar shprehimisht në kontratë, por që janë të domosdoshme për ekzekutimin e saj. Ekzekutimi nuk nënkupton vetëm kryerjen e veprimit juridik por vazhdon deri në kalimin e plotë të efekteve të porositësi.
2. Mund të pranohet si e vlefshme kontrata e porosisë për të kryer veprime juridike pas vdekjes së porositësit. Bazuar dhe në faktin që vdekja e porositësit nuk është gjithmonë shkak për shuarjen e porosisë sipas nenit 927/2 dhe 928/2 të Kodit Civil.
3. Kontrata e porosisë rregullon vetëm marrëdhëniet e brendshme që krijohen midis porositësit dhe të porositurit. Në parim këto marrëdhënie nuk ndikojnë në marrëdhënien e krijuar, nga veprimi juridik i kryer, midis të porositurit dhe personit të tretë.
4. Karakteri personal i porosisë nuk përjashton mundësinë e zëvendësimit të të porositurit. Kushtet e parashikuara në nenin 921/2 të Kodit Civil (që parashikojnë mundësinë e zëvendësimit) nuk duhet të interpretohen në mënyrë të ngushtë. Mundet që zëvendësimi të konsiderohet i ligjshëm kur edhe pse nuk ka qënë i autorizuar, nuk rezulton të jetë i ndaluar. Në rast zëvendësimi nuk do të ekzistojë përgjegjësi solidare e të porositurit me zëvendësin, sepse i porosituri del si subjekt nga marrëdhënia dhe hyn zëvendësi.
5. Në parim, për kontratën e porosisë ligji nuk kërkon detyrimin e respektimit të një forme të caktuar për efekt vlefshmërie. Por nëse solemniteti kërkohet për të ruajtur konsensusin, porosia duhet të ketë të njëjtën formë si veprimi juridik. Kontrata e porosisë për të kryer veprime juridike formale (sipas nenit

83 të Kodit Civil) duhet të bëhet me akt noterial për efekt vlefshmërie. Mundet që kontrata e porosisë për analogji me prokurën të bëhet me akt noterial. Por në këtë rast forma nuk është e detyrueshme për efekt vlefshmërie. Kontrata e porosisë duhet të bëhet me shkrim për efekt provueshmërie.

6. Kontrata e porosisë prezumohet me shpërblim. Si shpërblim mund të shërbejë një shumë të hollash (pavarësisht nga lloji i monedhës që përcaktohet nga palët), një send, një e drejtë dhe çdo gjë tjetër (psh. artikull në gazetë që të krijoj një sadsifaksion moral) që mund të krijoj avantazh për të porositurin, dhe që jepet përkundrejt veprimit juridik që ka kryer si kundërdetyrim i porositësit. Porosia nuk mund të jetë e pavlefshme për mospërcaktimin e çmimit. Çmimi në mungesë të përcaktimit nga palët është i përcaktueshëm, sipas kriterëve të parashikuara nga ligji, të cilat duhet të zbatohen sipas parimit hierarkik. Përcaktimi i shpërblimit sipas këtyre kriterëve bëhet nga gjykata, e cila duhet të caktoj ekspert për të bërë të mundur përcaktimin. Rekomandoj që gjykatat për përcaktimin e shpërblimit sipas këtyre kriterëve të caktojnë ekspert në çdo rast.
7. Kur flasim për pa/vlefshmërinë e kontratës së porosisë nëkuptojmë se për të do të zbatohen rastet e pavlefshmërive të veprimeve juridike. Pasojat e pavlefshmërisë do të ndryshojnë në varësi me llojin apo shkakun e pavlefshmërisë. Rast specifik i pavlefshmërisë së veprimeve juridike objekt porosie, është nëse jepet porosi e përgjithshme dhe i porosituri kryen dhe veprime të administrimit të jashtëzakonshëm. Këto veprime janë të pavlefshme.
8. Kontrata e porosisë duhet të dallohet nga kontratat e ngjashme. Objekti e dallon atë nga kontratat e tjera si kontrata e sipërmarrjes, komisionit dhe spedicionit. Mundësia e të porositurit për të vepruar dhe si përfaqësues i porositësit e dallon nga kontrata e komisionit, sipërmarrjes dhe ndërmjetësimit. Veçnisht duhet të dallojmë porosinë nga sipërmarrja. Ekzistenca e riskut, i cili rëndon mbi sipërmarrësin është element dallues specifik.

Bibliografia

Legjislacioni

Kodi Civil i datës 01.04.1929.

Ligji nr. 7632, datë 4.11.1992. *“Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar”.*

Literatura

Arta Mandro (Balili), *“E drejta romake”*, shtëpia botuese “Emal”, Tiranë 2007.

Ken Dhima, *“E drejta romake”*, shtëpia botuese “Medaur”, Tiranë 2007.

Valentina Kondili, *“E drejta civile I (pjesa e përgjithshme)”*, shtëpia botuese “Maluka”, Tiranë 2007.

Mariana Semini (Tutulani), *“E drejta e detyrimeve dhe e kontratave” (pjesa e posaçme)*, shtëpia botuese “Skanderbeg books”, Tiranë 2006.

- Juliana Latifi (Fuga), *“E drejta civile”(pjesa e përgjithshme)*, shtëpia botuese “Ilar”, Tiranë 2001.
- Mariana Semini (Tutulani), *“E drejta e detyrimeve dhe e kontratave”(pjesa e përgjithshme)*, shtëpia botuese “Afërdita”, viti 1998.
- Ken Dhima, “E drejta romake”, shtëpia botuese “Medaur”, Tiranë 2007, fq. 665.
- Prof. Asoc. Dr. Arta Mandro (Balili), “E drejta romake”, shtëpia botuese “Emal”, Tiranë 2007, fq. 386.
- Prof. Asoc. Dr. Arta Mandro (Balili), “E drejta romake”, shtëpia botuese “Emal”, Tiranë 2007, fq. 386.
- Prof. Asoc. Dr. Arta Mandro (Balili), “E drejta romake”, shtëpia botuese “Emal”, Tiranë 2007, fq. 387.
- Valentina Kondili, “E drejta civile I”(pjesa e përgjithshme), shtëpia botuese “Maluka”, Tiranë 2007, fq. 88
- Ardian Kalia, “E drejta ndërkombëtare private”, shtëpia botuese “Sejko”, Elbasan 2006, fq. 58
- J, Ghestin, J, Huet, “Traitè de droit civil- les principaux contrats speciaux, , II edition, Paris 1996, fq. 1112.
- Francesco Galgano, *“E drejta private”*, shtëpia botuese “Luarasi”, Tiranë 1999.

Praktikë Gjyqësore

- Vendimi nr. 1705 datë 23.10.2003, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Vendimin nr. 1886 datë 04.04.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
- <http://it.ëikipedia.org/ëiki/Mandato> (mars 2008)

Rregullimi i marrëdhënieve të punës në Shqipëri sipas ligjit “Për Nëpunësin Civil”, krahasimi me disa nga vendet e botës

Irisi Menga

Abstrakt

Nëpërmjet këtij punimi kam synuar që të sjell një trajtim sa më të veçant në lidhje me marrëdhëniet e punës në sektorin publik në Shqipëri, Europë dhe ShBA. Përmes këtij punimi synoj që të prek disa nga aspektet më të veçanta e me problematike të së drejtës së punës, pasi zbatimi në praktik i marrëdhënieve të punës në sektorin publik ka sjell mjaft problematika për zbatuesit e saj. Kam menduar të trajtoj këtë temë për vetë faktin se gjatë viteve të fundit është vërejtur një interes në rritje për rregullimin e marrëdhënieve të punës në sektorin publik, kjo për vetë veçantinë dhe objektin interesant që përçjell ky sektor krahasuar me sektorët e tjerë. Jam munduar që të sjell një analize teorike të legjislacionit, për marrëdhëniet e punës në sektorin publik duke evidentuar kështu avantazhet dhe disavantazhet që sjell në praktik zbatimi i ligjit “Për Nëpunësin Civil” në Shqipëri, kjo për të kuptuar me mirë se ku ka nevojë legjislacioni jonë të plotësohet, ndryshohet për të realizuar një rregullim sa më të mirë për këto marrëdhënie. Në këtë punim kam trajtuar në një vështrim krahasues në marrëdhëniet e punës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Angli, Francë dhe Gjermani duke evidentuar karakteristikat kryesore të legjislacionit të çdo shteti për rregullimin e këtyre marrëdhënieve të punës. Kuadri ligjor për marrëdhëniet e punës në shërbimet publike të vendeve europiane është përqendruar në rolin që luajnë punëdhënësit, qeveria dhe sindikatat. Duke marrë parasysh rëndësinë që paraqet ky sektor ai ka qenë objekt i reformimeve të shumta gjatë dy-tre dekadave të fundit, këto reforma janë një përgjigje e drejtëpërdrejtë e situatave të reja që dalin nga zbatimi në praktik dhe nga nevojat e një shoqërie e cila zhvillohet me rritme të shpejta dhe duhet ti paraprihet çdo situatë konfuzë në të ardhmen. Duke pasur parasysh